



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 191 /2012**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, për shkak të prezencës së personave të paautorizuar në Qendrën e Votimit (QV) 0719/02D gjatë ditës së Zgjedhjeve, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 21.06.2012, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 18.06.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se më datën 17.06.2012, në fshatin Kovaqec, në shkollën fillore “Idriz Seferi” QV0719 Vendvotimit (VV) 02D, kanë hyrë persona të panjohur që njiheshin me vëzhguesit e PDK-së, dhe siç potencon ankuesi ju kanë dhënë bexhat e tyre në mënyrë që këta persona të panjohur të mund të qëndrojnë në QV. Ankuesi ka theksuar si rast konkret Nazmi Muqa, vëzhgues i PDK-së i cili i ka dhënë bexhin Urim Mezdrajës, vëllau i Artan Mezdrajës, zyrtar i KKZ-së. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë rast është bërë shkelje e nenit 2 par. 2 pika 8 i Rregullës Zgjedhore 09/2009.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 18.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.06.2012, në ora 15:00.

PZAP, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, sipas afatit të caktuar. Në përgjigjen të ankesës subjekti politik PDK potencon se Ankesa është e pabazuar dhe për ne cilësohet qëllim keqe për të nxit konflikte.

PZAP-i, po ashtu e informoi Zyrën për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike (ZRPPC) - KQZ në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 18.06.2012, për ankesën e cila është paraqitur në PZAP nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dhe ka kërkuar përgjigje në kërkesë për të verifikuar se personat Nazmi Muça dhe Urim Mezdraja, a gjenden në listën e vëzhguesve të subjektit politik PDK të akredituara nga ZRPPC- KQZ për vëzhgimin e Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Kaçanik.

PZAP-i mori përgjigjen në ankesë nga ZRPPC, sipas afatit të caktuar, e cila ka vërtetuar se z. Nazmi Muça dhe Urim Mezdraja, nuk gjendet në listën e vëzhguesve të Partisë Politike (PDK) të akredituara nga KQZ-ja për vëzhgimin e Zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Kaçanik. ZRPPC, përgjigjes në kërkesë ia ka bashkangjitur listën e vëzhguesve të subjektit politik PDK.

PZAP-i nëpërmjet postes elektronike njoftoi edhe Selami Trupi, në cilësinë e kryesuesit të Vendvotimit 0719/02D në fshatin Kovaqeci, Komuna e Kaçanikut dhe ka kërkuar të përgjigjet në ankesë nëpërmjet postes elektronike deri më datë 19.06.2012 në ora 20:00.

PZAP-i nëpërmjet postës elektronike pranoi përgjigjen në ankesë sipas afatit të caktuar në të cilën deklaroi se në Vendvotimin 0719/02D, nuk ka pas asnjë parregullsi dhe ka cekur se unë kam qenë Kryesues dhe në klasën time askush nuk ka tentuar të hyj brenda apo të tentoj që të manipuloj diçka dhe e përsërit se nuk ka pasur kurrfarë parregullsie.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Sipas ankesës së parashtruar në PZAP pala ankuese pretendon se në shkollën fillore "Idriz Seferi" QV 0719/02D, kanë hyrë persona të panjohur që po njiheshin me vëzhguesit e PDK-së dhe siç potencion ankuesi Nazmi Muça vëzhgues i PDK-së, i ka dhënë bexhin Urim Mezdrajës, vëllau i Artan Mezdrajës, zyrtar i KKZ-së. PZAP-i nga përgjigja e ZRPPC, vërtetoi se Nazmi Muça dhe Urim Mezdraja nuk gjenden në listën e vëzhguesve të subjektit politik PDK të akredituara nga KQZ-ja për vëzhgimin e Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Kaçanik, siç pretendohet në ankesë.

Andaj PZAP-i, vlerësoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara nga shkakun se parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë apo dëshmi bindëse që do të mbështeste pretendimet ankimore që janë theksuar në ankesë. Prandaj PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë dhe në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë**

A nr. 191 /2012 më datën 21.06.2012.

